




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prillogur Më/Datë 08.04.2022			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
09-110/05	-	396	



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, shkronja d, neni 40, paragrafi 2, shkronja e dhe neni 51 paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), Udhëzimin Administrativ MAPL-05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen e kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë, neni 36 shkronja d, neni 40, 47 shkronja e të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 31.03.2022, merr këtë:

## V E N D I M

### për formimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

#### Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për formimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

#### Neni 2

Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka 5 (pesë) anëtarë dhe atë:

1. Valentina Mehmeti, anëtare e Kuvendit përfaqësuese nga subjekti politik LDK
2. Sokol Shaqiri, anëtar i Kuvendit përfaqësues nga subjekti politik LDK
3. Nexhat Halili, anëtar i Kuvendit përfaqësues nga subjekti politik LVV
4. Taulant Haxhiu, anëtar i Kuvendit përfaqësues nga subjekti politik PDK
5. Marigona Abazi, anëtare nga jashtë Kuvendi

Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në mbledhjen e parë do ta zgjedh kryesuesin e këtij Komiteti

#### Neni 3

Komiteti nga neni 1 i këtij vendimi, ka për detyrë që të shqyrtoj çështje të cilat kanë të bëjnë me gjendjen në shëndetësi dhe gjendjen sociale të banoreve të Komunës së Vitisë dhe të jep vërejtje, propozime dhe sugjerime për tejkalimin e gjendjes në shëndetësi dhe në mbrojtje sociale. Kryesuesi i Kuvendit, drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe kryesuesi i komitetit, më detajish mundën t'i përcaktoj detyrat e këtij Komiteti.

#### Neni 4

Anëtarët e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, të emëruar në neni 1 të këtij vendimi, emërohen me mandat të njëjtë si të anëtarëve të Kuvendit të Komunës

#### Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen kryesuesi i Kuvendit dhe kryesuesi i Komitetit.

#### Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. Anëtarëve të Komitetit; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË  
K R Y E S U E S I  
Bekim Azizi

